

V E N D I M
Nr.294, datë 8.5.2003

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.323, DATË 4.7.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN E KORPUSIT TREKATËSH TË “ALIMPEKS” SHA
SHKOZET, DURRËS NË PRONËSI TË MINISTRISË SË PUNËS DHE ÇËSHTJEVE
SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të nenit 2 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.323, datë 4.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e vendimit fjala “pronësi” të zëvendësohet me fjalën “administrim”.

2. Pika 1 të riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Regjistrimin e pasurisë së paluajtshme “Magazinat e korpusit trekatësh, me pamje nga deti, me sipërfaqe ndërtimi 1182,9 m2, që administrohet nga “Alimpeks” sh.a. në pronësi të Republikës së Shqipërisë dhe kalimin në administrim të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale”, si organ shtetëror përgjegjës për administrimin e pasurisë së paluajtshme të mësipërme.”.

3. Pika 2 të riformulohet si më poshtë vijon:

“Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale t’i japë Shoqatës së Invalidëve të Punës të Shqipërisë, për nevoja të saj, pasurinë e paluajtshme të treguar në pikën 1 të këtij vendimi, në huapërdorje, pa kundërshpërblim dhe të nënshkruajë e ndjekë zbatimin e kontratës përkatëse të huapërdorjes.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano